



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:240169

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05407140

C.nr.80/17

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses K...me seli në Prishtinë, rruga .. kundër të paditurit A.A nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, me objekt kontesti Rimbursim dëmi, në seancën përgatitore të mbajtur me datë 04.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia C.nr.80/17 e datës 23.01.2017, e paditëses K...me seli në Prishtinë, rruga ..., kundër të paditurit A.A nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, me objekt kontesti Rimbursim dëmi.

A r s y e t i m

Paditësja K...me seli në Prishtinë, rruga ..., në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit A.A nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, me bazë juridike-Rimbursim dëmi.

Në seancën përgatitore të mbajtur me datë 04.03.2024, nuk ka prezantuar paditësja dhe mungesën nuk e ka arsyetuar edhe përkundër thirrjes së rregullt siç konstatohet nga fletëkthesa e datës 12.02.2024, po ashtu nuk ka prezantuar i padituri A.A, përkundër thirrjes së rregullt siç konstatohet nga fletëkthesa e datës 08.02.2024.

Meqenëse, paditësja K..., përkundër ftesës me rregull, nuk ka prezantuar në seancë dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, konsiderohet se e ka tërhequr padinë kundër të paditurit A.A.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 409 par.1 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.80/17, me datë 04.03.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.